

NJOFTIM

PËR REKRUTIMIN E NJË SPECIALISTI PËR ZYRËN RAJONALE SHKODËR

Mbështetur në nenin 32 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ligjin nr. 7961, datë 12/07/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe në organigramën dhe strukturën organizative, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon të rekrutojë një specialist për Zyrën Rajonale Shkodër.

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve

Kandidatët që duan të aplikojnë për këtë pozicion pune, duhet të plotësojnë kriteret dhe procedurat e mëposhtme:

- ✓ Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Juridike. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi).
- ✓ Të ketë të paktën 2(dy) vjet përvojë pune në profesion. Njohja e legjislacionit shqiptar dhe/ose akteve ndërkombëtare në fushën e drejtave të njeriut do të konsiderohet përparësi;
- ✓ Të ketë njohuri të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar;
- ✓ Të ketë aftësi organizative dhe administrative si dhe veçanërisht aftësi komunikimi;
- ✓ Të ketë standarde të larta të integritetit dhe përvojës në trajtimin e informacionit konfidencial;
- ✓ Të ketë fleksibilitet, aftësi të forta adaptimi dhe aftësi për punë në ekip;
- ✓ Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet Microsoft Word, Excel, si dhe njohuri të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit (IT).

Përshkrimi i punës

Detyrat e specialistit të Zyrës Rajonale Shkodër janë:

- Zbatimi i ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, Rregullores së Brendshme, Kodit Etik të Institucionit si dhe akteve të tjera të miratuara nga Avokati i Popullit.
- Pritja e qytetarëve, komunikimi me etikë, kthimi i përgjigjeve të ankesave të mëparshme, dhënia e udhëzimeve për mënyrën e plotësimit të formularit (elektronik dhe printuar) të ankesës.

- Dhënia e këshillave dhe orientimi i qytetarëve, për rrugën që duhet të ndjekin apo Institucionit që duhet t'i drejtohen, për ankesat që janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit.
- Dërgimi në zyrën qendrore të Avokatit të Popullit, në rrugë postare ose elektronike, të ankesave të marra gjatë javës. Për raste që kërkojnë shqyrtim të menjëhershëm nga ekspertët sipas fushave, ankesa dërgohet brenda 24 orëve, në zyrën qendrore të Avokatit të Popullit.
- Ruajtja e fshehtësisë së informacionit dhe identitetit të qytetarit që bën ankesën duke mos i bërë ato në asnjë rast publike.
- Mospranimi i ankesave anonime dhe pa nënshkrimin e ankuesit.
- Bashkëpunimi me zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Kryerjen e raportimeve javore, mujore dhe vjetore për numrin e ankesave të qytetarëve, të këshillimeve dhe orientimeve, si dhe kërkesave që lidhen me mbarëvajtjen e zyrës rajonale.
- Të kërkojë nga zyra qendrore e Avokatit të Popullit në Tiranë, interpretime të akteve ligjore dhe nën-ligjore, udhëzime për raste specifike dhe sa herë ai e shikon të nevojshme.
- Të kryejë në kohë të shpejtë, pa vonesa dhe me efikasitet çdo detyrë tjetër që do ti caktohet nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Periudha dhe vendndodhja

Afati i rekrutimit do të përcaktohet në kontratën e punës, duke respektuar dispozitat e ligjin nr. 7961, datë 12/07/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në varesi të performancës dhe vlerësimit të punës. Vendndodhja e pozicionit të punës do të jetë në qytetin e Shkodrës.

Pagesa

Pagesa do të kryhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, Lidhja nr.12, Kategoria IV-2.

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit:

Aplikimi duhet të përmbajë:

- ✓ Letër motivimi
- ✓ Curriculum Vitae (CV)
- ✓ Kopje të diplomës
- ✓ Kopje të librezës së punës
- ✓ Dëshmi të gjuhës së huaj (nëse ka)
- ✓ Vërtetim të gjendjes gjyqësore

Aplikimet duhet të dërgohen në rrugë elektronike në adresën: burime.njerezore@avokatipopullit.gov.al; ose në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

***Institucioni i Avokatit të Popullit
Blv. “Zhan D’Ark”, nr.2, Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të Sektorit të Burimeve Njerezore***

Afati

Aplikimet pranohen deri në datë 19. 02. 2025, ora 16:30. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumenteve vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.